



**ORGANIZATA PËR DEMOKRACI,  
ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU!**  
ZYRA E INFRASTRUKTURËS ANTI-KORRUPSION DHE KËSHILLTARIT LIGJOR

**RAPORT MONITORUES**

Parashkrimi i Ndjekjeve Penale  
dhe Ekzekutimeve Penale

**SERIA E RAPORTIT # 1**

**JANAR 2012**

Rruga “2 Korriku” 4/4, Prishtinë, 10000  
organizatacohu@yahoo.com  
www.cohu.org

Ky botim është realizuar me përkrahjen e **Civil Rights Defenders-** (CRD)  
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Organizatës ÇOHU!**.

Përgatitur nga: Arton Demhasaj  
Ndihmuar nga: Lorik Bajrami dhe Besa Kalaja

Botuar nga:

Organizata për Demokraci, Anti-  
korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!  
Rruga: 2 Korriku; Nr.4; Hy.4  
Prishtinë, Kosovë  
Tel / +381 (0)38 2248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

## **METODOLOGJIA:**

Ky Raport Monitorues, është rezultat i hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ i cili për bazë ka burime primare dhe sekondare. Sa i përket burimeve primare, janë përdorur metodat e intervistimit direkt të akterëve relevant të fushës së gjyqësorit (gjykata komunale, Prokurori Disiplinor, Kryetari i Gjykatës Supreme, Policia e Kosovës dhe Kryeprokurori i Shtetit), si dhe analizimi i të dhënave nga Gjykatat komunale të Kosovës. Po ashtu, për nevoja të këtij raporti, janë konsultuar edhe Ligjet penale (Kodi Penal i Kosovës, Ligji Penal i Kosovës), si dhe aktet tjera juridike.

Për burimet sekondare, janë marrë për bazë edhe analiza tjera politikash, hulumtime të opinionit si dhe reagime që fokusohen në fushën e gjyqësorit, me theks të veçantë të fushës penale (parashkrimin e lëndëve penale). Për më shumë, janë konsultuar edhe burime të tjera të informacionit si mediet elektronike dhe të shkruara.

Në këtë raport monitorues janë marrë për bazë 14 gjykata komunale. 5 gjykata komunale janë marrë që kanë numër të madh të banorëve (Gjykata Komunale e Prishtinës, e Prizrenit, Pejës, Gjakovës dhe Ferizajt), 4 gjykata të vogla me numër të ulët të lëndëve të parashkuara (Gjykata Komunale e Glllogocit, e Lipjanit, Skenderajt dhe Malishevës), dhe 5 gjykata të vogla me numër të madh të lëndëve të parashkuara (Gjykata Komunale e Kaçanikut, e Suharekës, e Deçanit, e Klinës, dhe ajo e Istogut).

Qëllimi ishte që të dhënat e mbledhura të klasifikohen në bazë të komunave për të pasur parasysh se cilat janë gjykatat komunale që kanë më së shumti lëndë të parashkuara. Për më shumë, klasifikimi i lëndëve të parashkuara në vite është bërë mënyrë që të kemi një pasqyrë se cilat janë vitet që më së shumti kanë lëndë të parashkuara. Dhe në fund, lëndët e parashkuara janë ndarë në bazë të kapitujve të KPK-së, në mënyrë që të identifikohet se cili është kapitulli që ka më së shumti lëndë të parashkuara dhe cilat janë veprat penale që më së shumti janë parashkuara.

**SHKURTESAT:**

**CRD**- Civil Rights Defenders

**KPK**- Kodi Penal i Kosovës

**LPK**- Ligji Penal I Kosovës

**ZPD**- Zyra e Prokurorit Disiplinor

**KGJK**- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**GJK**- Gjykatat Komunale

**PQP**- Prokuroria e Qarkut e Prishtinës

**PSH**- Prokuroria e Shtetit

**GJKGJ**- Gjykata Komunale e Gjakovës

**PK**- Policia e Kosovës

**GJSK**- Gjykata Supreme e Kosovës

**PTK**- Posta dhe Telekom i Kosovës

**PËRMBAJTJA:**

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME:.....	1
2. HYRJE:.....	2
<i>a) Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe</i>	
<i>b) Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve</i>	
3. TË GJETURAT E PËRGJITHSHME.....	5
Parashkrimi i lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit.....	13
Kundërthëniet në mes Gjykatës Supreme dhe Gjykatave Komunale.....	15
4. PËRFUNDIMI.....	19

**Përmbledhje e përgjithshme:**

**K**osova vazhdon të kalojë nëpër një tranzicion turbulent dhe me pengesa serioze në ndërtimin e institucioneve demokratike. Togfjalëshi “sundimi i ligjit”, vazhdon të jetë dominues vetëm në retorikën e zyrtarëve publik, por jo edhe rregull përcaktues i funksionimit të institucioneve publike. Në këtë kuadër, sistemi i drejtësisë në Kosovë, përkundër që ka tërhequr një fokus të veçantë dhe sistematik të diskursit publik, dhe të resurseve të ndryshme në ndërtimin e tij, vazhdon të ballafaqohet me sfida dhe probleme të rënda dhe hera herës të pakapërcyeshme.

Aspekti i parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale është mjaft shqetësues në gjykatat e Kosovës. Nga viti 2001 deri me 2011, kemi një numër të madh të lëndëve penale të cilat janë vjetërsuar, dhe si pasojë e kësaj, gjykatat nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim juridik për të ndjekur penalisht të dyshuarit, ose për të arrestuar të dënuarit.

Nga gjithsej 4197 lëndë penale që janë parashkruar nga 14 Gjykata Komunale që janë marrë në shqyrtim, mbi 54%<sup>1</sup> e tyre që janë të kategorizuara i përkasin parashkrimit relativ, ndërsa 46% i përkasin parashkrimit absolut. Për lëndët e parashkruara në aspektin relativ duhet të fajësohen gjyqtarët, të cilët duke mos ndërmarrë asnjë veprim, kanë lejuar vjetërsimin e këtyre lëndëve. Gjykata në vend se të luftojë veprat e ndryshme të dënuara me ligjet në fuqi, të gjykojë dhe të dënojë shkelësit e ligjeve në fuqi dhe të Kodit Penal të Kosovës, ata me këto veprime kanë amnistuar veprat e kryera si dhe kryesitë e tyre. Gjykatësit, duke i mbajtur lëndët e tyre nëpër sirtarë (duke mos i shqyrtuar), dhe njëkohësisht duke lejuar që këto lëndë të parashkruhen, kanë pamundësuar ndërmarrjen e çfarëdo veprimeve penale kundër veprave të ndryshme dhe shkatërrues të tyre. Me këtë veprim, gjykatësit kanë shkelur rëndë mbi parimin e një gjykimit të drejtë dhe fer, duke mundësuar kështu vendosjen e një precedenti të rrezikshëm në këtë drejtim.

Të dhënat që janë mbledhë nga gjykatat komunale tregojnë se shifrat e lëndëve të parashkruara janë shumë më të mëdha se sa ato që i kemi siguruar nga Gjykata Supreme. Të dhënat e Gjykatës Supreme tregojnë se në 21 gjykata komunale, janë parashkruar gjithsejtë 6358 lëndë. Ndërsa, nga 14 gjykata komunale që janë marrë për bazë në këtë raport monitorues, janë gjithsej 4197 lëndë të parashkruara. Trendi i të

<sup>1</sup> Kjo përqindje nënkupton vetëm atë të lëndëve që janë të kategorizuara në parashkrim absolut dhe relativ, pa i llogaritur edhe 603 lëndë që janë të pa-kategorizuara.

dhënave të siguruara nga ÇOHU!, tregon se shumica nga 14 gjykatat komunale të marra në konsiderim kanë ngritje të numrit të lëndëve të parashkuara krahasuar me të dhënat e Gjykatës Supreme, përjashtuar Prizrenit i cili ka një ulje përafërsisht 50% më pak, krahasuar me të dhënat e Gjykatës Supreme. Ky trend tregon që numri total i lëndëve të parashkuara nga gjykatat komunale, përgjatë viteve 2001-2011, mund të jetë afër 7000 sosh.

Ky raport monitorues, tregon që në mesin e lëndëve që janë parashkuar ka edhe lëndë që i përkasin kapitullit të KPK-së: “Vepra kundër detyrës zyrtare”, që klasifikohen si vepra të korrupsionit. Por po ashtu, ky raport monitorues tregon që ka edhe vepra që janë parashkuar e që i përkasin kapitullit të KPK-së: “Vepra penale kundër të drejtës ndërkombëtare”, e është në realitet, parashkrimi i tyre është në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare.

Edhe përkundër miratimit të Strategjisë Shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Grumbulluara, në tetor të vitit 2010, prapë se prapë trendi i lëndëve të parashkuara ka vazhduar edhe në vitin 2011. Për më keq, ka tendenca të qarta që parashkrimi i lëndëve të vazhdojë edhe në të ardhmen nëse nuk fillohet të ndërmerren masa disiplinore dhe penale për ata gjyqtarë të cilët lejojnë vjetërsimin e lëndëve, për të cilat kanë qenë të ngarkuar që t’i shqyrtojnë.

Për këtë çështje, disa herë është përmendur se janë filluar hetime për gjyqtarët që kanë lejuar vjetërsimin e lëndëve, nga ana e Zyrës së Prokurorit Disiplinor pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, “por asnjë prej tyre nuk ka rezultuar me shkarkimin e tyre”<sup>2</sup>. Disa herë është potencuar fakti se gjykatat po lejojnë më qëllim parashkrimin e lëndëve penale me një interes të caktuar, dhe se do të ndërmerren masa ndaj tyre, por në praktikë akoma nuk kemi ndonjë rezultat. Deri me sot, nuk kemi asnjë rast që një gjyqtar është shkarkuar për shkak se ka lejuar vjetërsimin e lëndës për të cilën ka qenë i ngarkuar ta shqyrtoj.

Sipas legjislacionit penal në fuqi, përgjegjës për lëndët që janë parashkuar në aspektin relativ janë gjykatat (Gjyqtarët kompetent), dhe ndaj tyre është dashur të ndërmerren masa disiplinore dhe penale për shpërdorim të detyrës zyrtare, dhe lejim më qëllim të parashkrimit të mijëra lëndëve penale që kanë qenë në duart të tyre.

<sup>2</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2011.

**Hyrje:****a) Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe****b) Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve**

“Parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik i cili shpie në shuarjen e sanksioneve penale për shkak të kalimit të kohës së caktuar me ligj. Kur paraqitet parashkrimi, shteti humb të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale ndaj kryesit të veprës penale”<sup>3</sup>.

Parashkrimi i lëndës lindë kur kryesi i veprës penale nuk mund të zbulohet, ose mund të ndodhë që kryesi të dihet por organet e ndjekjes penale nuk mund ta gjejnë atë. Po ashtu, mund të ndodhë që kryesi i veprës penale të dënohet, por pas shqiptimit të dënimit paraqiten pengesa reale apo juridike të cilat e bëjnë të pamundshme ekzekutimin e dënimit p.sh. (i dënuari sëmurët rëndë ose arratiset pas shqiptimit të dënimit).<sup>4</sup>

Në të gjitha këto raste, nëse prej kryerjes së veprës penale/prej shqiptimit të dënimit, deri të ndërmarrja e ndjekjes penale ka kaluar një kohë e caktuar, me ligj nuk mund të ndërmerret ndjekja penale/nuk mund të ekzekutohet dënimi i shqiptuar. Me kalimin e kohës, prej kryerjes së veprës penale deri te fillimi i ndjekjes bëhet parashkrimi i ndjekjes penale, ndërsa me kalimin e kohës prej shqiptimit të dënimit bëhet parashkrimi i ekzekutimit të dënimit. Shteti në këto raste, sipas ligjeve që e ka nxjerrë, humb të drejtën e shqiptimit apo ekzekutimit të dënimit.<sup>5</sup>

E Drejta Penale në përgjithësi njih dy lloje të parashkrimit: **1. parashkrimin e ndjekjes penale** dhe **2. parashkrimin e ekzekutimit të dënimit**. Të dy llojet e parashkrimit mund të ndahen pastaj në parashkrim relativ dhe absolut. Parashkrimi relativ<sup>6</sup>, nënkupton kalimin e afatit të paraparë me ligj prej kohës së kryerjes së veprës penale deri në momentin kur nuk mund të fillohet ndjekja ose nuk mund të filloj ekzekutimi tek parashkrimi i ekzekutimeve të dënimeve. Ndërsa parashkrimi absolut<sup>7</sup> nënkupton kalimin e dyfishit të kohës së paraparë me ligj, prej momentit të kryerjes së veprës penale deri në kohën ku nuk mund të fillohet ndjekja, ose ekzekutimi i dënimit të shqiptuar tek rasti i parashkrimi të ekzekutimeve të dënimeve.

<sup>3</sup> Salihu, Ismet; *“E Drejta Penale”*; Universiteti Fama, Prishtinë, 2008, faqe558.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Salihu, Ismet; *“E Drejta Penale”*; Universiteti Fama, Prishtinë, 2008, faqe559-560.

<sup>6</sup> Po aty, faqe 563

<sup>7</sup> Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit mund të shpiejnë praktikisht që kurrnjëherë të mos shkaktohet parashkrimi. Sidomos me ndërprerjen gjithëherë mund të ndërmarrin veprime me të cilat do të bënin të pamundshme kuptimin dhe qëllimin e parashkrimit. Për t’iu shmangur kësaj mundësie, e drejta penale bashkëkohore parasheh parashkrimin absolute. Po aty faqe 563.



Sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), ekziston: **a)** parashkrimi i ndjekjes penale dhe **b)** parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve.

Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse kemi ndërprerje të afatit të parashkrimit, atëherë ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).<sup>8</sup>

Sipas nenit 90 të KPK-së, **ndjeka penale** nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:

- 1) Tridhjetë e pesë vjet** nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim afatgjatë;
- 2) Pesëmbëdhjetë vjet** nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë vjet** nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim;
- 4) Pesë vjet** nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;
- 5) Tre vjet** nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim dhe;
- 6) Dy vjet** nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ose dënim me gjobë.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm. Nëse afati i parashkrimit të ekzekutimit të vendimeve ndërprehet me vendim ose sipas ligjit, atëherë, ekzekutimi i dënimeve ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet nga ligji për afatin e parashkrimit (ndalimi absolut i ekzekutimit të dënimeve).<sup>9</sup>

Nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit mbi ekzekutimin e dënimit për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi.<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Kodi Penal i Kosovës neni 91.

<sup>9</sup> Kodi Penal i Kosovës neni 94.

<sup>10</sup> Kodi Penal i Kosovës neni 95.

Sipas nenit 92 të KPK-së, **dënimi i shqiptuar** nuk mund të ekzekutohet kur të kenë kaluar:

- 1) **Tridhjetë e pesë** vjet nga dënimi me burgim afatgjatë;
- 2) **Pesëmbëdhjetë** vjet nga dënimi me mbi dhjetë vjet burgim;
- 3) **Dhjetë** vjet nga dënimi me mbi pesë vjet burgim;
- 4) **Pesë** vjet nga dënimi me mbi tri vjet burgim;
- 5) **Tri** vjet nga dënimi me mbi një vit burgim dhe;
- 6) **Dy** vjet nga dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë.

#### **TË GJETURAT E PËRGJITHSHME:**

Nga gjithsej 14 gjykata komunale<sup>11</sup> që janë marrë për bazë në këtë raport monitorues, del se prej vitit 2001 deri në vitin 2011 janë parashkruar 4197 lëndë penale që përfshinë edhe parashkrimin e ndjekjeve penale dhe parashkrimin e ekzekutimeve penale.


Prej totalit të lëndëve të parashkuara, 1955 lëndë janë që i përkasin parashkrimit relativ, që nënkupton se gjyqtarët nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar parashkrimin apo vjetërsimin relativ të tyre, por kanë lejuar që këto lëndë të parashkruhen/vjetërsohen. Për këto lëndë që janë parashkruar në aspektin relativ mund të fajësohen gjyqtarët që nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor me të cilin kanë mundur të ndërprejnë afatin e parashkrimit relativ të lëndëve. “Vjetërsimi relativ mund të pengohet së paku me një veprim të caktuar procedural. Në qoftë se ndërmerret një veprim i caktuar procedural parashkrimi relativ mund të shtyhet, do të thotë një veprim i vogël shtyhet afati i parashkrimit si p.sh dërgimi i një ftese, dërgimi i një kërkesë, një informacion i kërkuar në polici”<sup>12</sup> etj. Me këto veprime, gjykatësit mund të ndërprejnë afatin e parashkrimit relativ, dhe mund të shtyjnë parashkrimin e lëndës deri në dyfishin e afatit (parashkrimin absolut).

<sup>11</sup> Të dhënat nga Gjykata Komunale e Kaçanikut, janë vetëm për vitet 2010 dhe 2011. Kjo për arsye se gjykata ka kërkuar një kohë të gjatë (disa muaj) për t’i nxjerr dhe përpunuar të dhënat e kërkuar për vitet 2001-2011.

<sup>12</sup> Intervistë me Kadri Begollin prokuror në Komisionin Disiplinor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Me 18-01-2012.

**Tabela: 1 - Parashkrimi Gjyqësor i Lëndëve Penale në Shqyrtim dhe në Ekzekutim në vitet 2001-2011, në  
Gjykatat Komunale të Kosovës.**

<b>Gjykatat Komunale</b>	<b>Parash. Relativ</b>	<b>Parash. Absolut</b>	<b>Të pa kategoriz uara</b>	<b>Numri total i lëndëve të parashkrua ra</b>
GJ. Komunale e Ferizajt	400	470	-	<b>870</b>
GJ. Komunale e Prizrenit	194	487	-	<b>681</b>
GJ. Komunale e Deçanit	508	6	-	<b>514</b>
GJ. Komunale e Gjakovës	137	20	304	<b>461</b>
GJ. Komunale e Pejës	374	61	-	<b>435</b>
GJ. Komunale e Klinës	-	-	299	<b>299</b>
GJ. Komunale e Prishtinës	47	229	-	<b>276</b>
GJ. Komunale e Istogut	212	30	-	<b>242</b>
GJ. Komunale e Malishevës	45	169	-	<b>214</b>
GJ. Komunale e Kaçanikut	2	91	-	<b>93</b>
GJ. Komunale e Suharekës	34	44	-	<b>78</b>
GJ. Komunale e Lipjanit	-	17	-	<b>17</b>
GJ. Komunale e Skenderaj	1	12	-	<b>13</b>
GJ. Komunale e Gllogocit	1	3	-	<b>4</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1955</b>	<b>1639</b>	<b>603</b>	<b>4197</b>



**Grafikoni 1. Këtu paraqitet grafikoni i lëndëve të parashkuara si nga aspekti relativ ashtu edhe nga aspekti absolut, dhe totali i lëndëve të parashkuara në disa gjykata komunale të Kosovës.**

Për formën e parashkrimit relativ përgjegjës janë ata bartës të funksioneve të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndë, edhe pse nuk përjashtohet mundësia e pamundësisë së përbaljes me numër të madh të lëndëve. Megjithatë, fajin më të madh e kanë bartësit që kanë qenë të angazhuar me këto çështje.

**Tabela. 2 - Parashkrimi i Lëndëve Penale të ndara në vite.**

Vitet	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategorizuara	Totali i lëndëve
<b>2001</b>	17	1	5	<b>23</b>
<b>2002</b>	27	2	4	<b>33</b>
<b>2003</b>	81	57	13	<b>151</b>
<b>2004</b>	92	260	39	<b>391</b>
<b>2005</b>	456	289	57	<b>802</b>
<b>2006</b>	155	180	41	<b>376</b>
<b>2007</b>	254	62	49	<b>365</b>
<b>2008</b>	167	25	91	<b>283</b>
<b>2009</b>	19	37	-	<b>56</b>

<b>2010</b>	28	120	-	<b>148</b>
<b>2011</b>	12	63	-	<b>75</b>
<b>Të pa kategorizuara ne vite</b>			1494	<b>1494</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1308</b>	<b>1096</b>	<b>1793</b>	<b>4197</b>

Nëse i ndajmë në vite lëndët që janë parashkruar, del se vitet që më së shumti janë parashkruar lëndët penale janë vitet nga 2004 deri në 2008. Nga gjithsej 4197 që janë parashkruar prej vitit 2001 deri 2011, 802 lëndë janë parashkruar vetëm në vitin 2005. Nëse i marrim lëndët që janë parashkruar nga viti 2004 deri në 2008, del se janë 2217 lëndë të parashkruar në këto vite. Kjo nënkupton se më tepër se gjysma e lëndëve nga totali i lëndëve të parashkruara i përkasin viteve pas miratimit të Kodit Penal të Kosovës. KPK-ja ka hyrë në fuqi në prill 2004, dhe gjysma e lëndëve që janë parashkruar i përkasin viteve pas 2004-tës. Me KPK-ë, janë paraparë edhe afatet e parashkrimit, dhe gjykatat nuk kanë bërë asgjë për të parandaluar parashkrimin e lëndëve që kanë qenë në rrezik të parashkrimit. Kjo nënkupton se gjysma e lëndëve janë parashkruar katër vite pas hyrjes së KPK-së në fuqi.


Trendi i parashkrimit të lëndëve penale ka qenë më i madh pas hyrjes së KPK-së në fuqi se sa para hyrjes. Kjo tregon që gjykatësit, në vend që të ndërmarin masa për parandalimin e parashkrimit të lëndëve penale, ata përkundrazi kanë lejuar që të rritet edhe më tepër numri i lëndëve që parashkruhen.

Edhe pse ka filluar inventarizimi i lëndëve në vitin 2010, me Strategjinë Shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Grumbulluara<sup>13</sup>, prapë se prapë trendi i parashkrimeve të lëndëve ka vazhduar në masë të madhe ku në vitin 2010 kemi 148 lëndë të parashkruara, dhe në vitin 2011<sup>14</sup> kemi 75 lëndë të parashkruara. Kjo nënkupton se edhe pas fillimit të inventarizimit të lëndëve, proces që ka filluar në nëntor 2010 dhe afati i fundit ka qenë nëntori i 2011<sup>15</sup>, prapë ka pasur numër të madh të lëndëve të parashkruara.

<sup>13</sup> Kjo strategji është miratuar me 08-nëntor-2010, dhe si qëllim ka inventarizimin e lëndëve në gjykata dhe lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit në mes të gjykatave dhe policisë, PTK-së etj. Që të rritet efikasiteti i punës së gjykatave që sa më shumë të zgjidhen lëndët që mos të parashkruhen.

<sup>14</sup> Këtu mund të mos jetë numri total i lëndëve të parashkruara për vitin 2011, sepse të dhënat nga gjykata janë marrë nga qershori deri në dhjetor të vitit 2011, që nënkupton se mund të ketë edhe lëndë tjera që janë parashkruar në këtë vit por që gjykatat nuk i kanë të dhënat akoma.

<sup>15</sup> Hartimi i një plani në secilën gjykatë përmes së cilës do të përcaktohej:



**Grafikoni 2. Ky grafikon tregon trendët e lëndëve të parashkuara të ndara në vite.**


Veprat penale që janë parashkuar më së shumti ju përkasin kapitujve: **23-Veprat Penale Kundër Pasurisë, 24-Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, 28- Veprat Penale Kundër Rendit Publik dhe Veprimeve Juridike, dhe 15 -Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit.** Marrë së bashku, vetëm nga këto katër kapituj të KPK-së janë parashkuar 2146 lëndë penale, që kalon gjysmën e totalit të lëndëve të parashkuara nga gjithsej 17 kapituj sa ka pjesa e posaçme e KPK-së.

Inventarizimi, i cili duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e lëndës: numri i lëndës, lloji i lëndës, vlera, palët, etj. **Të fillojë menjëherë dhe të përfundojë brenda 1 muajit në gjykatat që kanë një inventar ekzistues, 3 muajve në gjykatat e vogla dhe 6 muajve në gjykatat e mëdha.** Vendoset nga Kolegjiumi Zbatohet nga Kryetari dhe Administratori. Strategjia shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara, e miratuar me 08-nëntor-2010.

**Tabela 3. Parashkrimi i Lëndëve Penale të ndara në bazë të kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së).**

<b>Kapitujt sipas KPK-së</b>	<b>Parash. Relativ</b>	<b>Parash. Absolut</b>	<b>Të pa kategorizuara</b>	<b>Totali i lëndëve</b>
<b>Kap.13</b> <u>Veprat Penale Kundër Kosovës dhe Banorëve të saj.</u> <b>Nenet 108-115</b>	8	-	-	<b>8</b>
<b>Kap.14</b> <u>Veprat Penale Kundër të Drejtës Ndërkombëtare</u> <b>Nenet 116-145</b>	-	4	-	<b>4</b>
<b>Kap.15</b> <u>Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit</u> <b>Nenet 146-157</b>	103	132	-	<b>235</b>
<b>Kap.16</b> <u>Veprat Penale Kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut</u> <b>Nenet 158-181</b>	46	80	-	<b>126</b>
<b>Kap.17</b> <u>Veprat Penale Kundër të Drejtave në Marrëdhënie të Punës</u> <b>Nenet 182-186</b>	4	31	-	<b>35</b>
<b>Kap.18</b> <u>Veprat Penale Kundër Nderit dhe Autoritetit</u> <b>Nenet 187- 191</b>	6	6	-	<b>12</b>
<b>Kap.19</b> <u>Veprat Penale Kundër Integritetit Seksual</u> <b>Nenet 192- 204</b>	14	1	-	<b>15</b>
<b>Kap.20</b> <u>Veprat Penale Kundër Martesës dhe Familjes</u> <b>Nenet 205- 214</b>	2	3	-	<b>5</b>
<b>Kap.21</b> <u>Veprat Penale Kundër Shëndetit Publik</u> <b>Nenet 215- 231</b>	2	2	-	<b>4</b>
<b>Kap.22</b> <u>Veprat Penale Kundër Ekonomisë</u> <b>Nenet 232- 251</b>	28	21	-	<b>49</b>
<b>Kap.23</b> <u>Veprat Penale Kundër Pasurisë</u> <b>Nenet 252-275</b>	463	337	-	<b>800</b>
<b>Kap.24</b> <u>Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore.</u> <b>Nenet 276-290</b>	432	177	-	<b>609</b>
<b>Kap.25</b> <u>Veprat Penale Kundër Sigurisë së Përgjithshme të Njerëzve dhe Pasurisë.</u> <b>Nenet 291-296</b>	31	57	-	<b>88</b>
<b>Kap.26</b> <u>Veprat Penale Kundër Sigurisë së Trafikut</u>	27	19	-	<b>46</b>

<b>Nenet 297-302</b>				
<b>Kap.27 Veprat Penale Kundër Administrimit të Drejtësisë</b>	11	6	-	<b>17</b>
<b>Nenet 303- 215</b>				
<b>Kap.28 Veprat Penale Kundër Rendit Publik dhe Veprimeve Juridike. Nenet 316-338</b>	319	183	-	<b>502</b>
<b>Kap.29 Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare Nenet 339-351</b>	6	3	-	<b>9</b>
<u>Sipas Ligjeve tjera Penale(LPK)</u>	-	-	107	<b>107</b>
<u>Të pa Kategorizuar në nene sipas KPK-së</u>	400	470	656	<b>1526</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1902</b>	<b>1532</b>	<b>763</b>	<b>4197</b>



**Grafikoni 3. Ky grafik tregon ndarjen e lëndëve të parashkuara në bazë të kapitujve të KPK-së**



**Parashkrimi i lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit:**

Përkundër deklaratave të gjykatave, por edhe të zyrtarëve të lartë politik, se lëndët që janë kundër detyrës zyrtare/korrupsionit kanë prioritet dhe se nuk mund të ketë parashkrim të lëndëve penale kundër detyrës zyrtare<sup>16</sup>, kemi parashkrim edhe të lëndëve të po kësaj natyre. Janë gjithsej 9 lëndë kundër detyrës zyrtare/korrupsionit që janë parashkruar, prej të cilave 6 janë të parashkruar në aspektin relativ, për të cilat duhet të fajësohen gjykatat, dhe 3

janë të parashkruar në aspektin absolut. Kjo do të thotë se gjykatat komunale të Kosovës nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për parandalimin e parashkrimit të

{Janë gjithsej 9 lëndë kundër detyrës zyrtare/korrupsionit që janë parashkruar, prej të cilave 6 janë të parashkruar në aspektin relativ, për të cilat duhet të fajësohen gjykatat, dhe 3 janë të parashkruar në aspektin absolut}

lëndëve kundër detyrës zyrtare, të cilat e dëmtojnë direkt edhe buxhetin e vendit dhe prekin drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Veprat penale kundër detyrës zyrtare që janë parashkruar janë: **neni 339 shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit 8 lëndë**<sup>17</sup>, 5 nga të cilat janë parashkruar në aspektin relativ dhe 3 janë parashkruar në aspektin absolut. Dhe **neni 348 falsifikimi i dokumentit zyrtar** ka 1 lëndë<sup>18</sup> që është e parashkruar nga aspekti relativ.

Veprat penale që janë parashkruar më së shumti iu përkasin kapitujve të KPK-së që po ashtu kanë më së shumti vepra penale të parashkruara. 1742 lëndë që janë parashkruar i përkasin vetëm pesë veprave penale që janë: Neni 285- **Vjedhja e Pyllit** me 595 lëndë, Neni 252- **Vjedhja** me 360 lëndë, Neni 332- **Falsifikimi i Dokumentit** me 285 lëndë, Neni 261- **Mashtrimi** me 270 lëndë, dhe Neni 153- **Lëndim i Lehtë Trupor** me 232 lëndë. Kjo i bie që afër 40 % e të gjitha lëndëve të parashkruara i përkasin vetëm pesë veprave penale.

<sup>16</sup> Në një intervistë dhënë Organizatës ÇOHU! Kryetari i Gjykatës Supreme z. Fejzullah Hasani, ka deklaruar se nuk mund të ketë parashkrim të lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit, për arsye se afati i parashkrimit është më i gjatë. Ai ka deklaruar se lëndët të cilat mund të parashkruhen janë kryesisht vepra penale të lehta të cilat afatin e parashkrimit e kanë të shkurtër. Intervista është zhvilluar në Gjykatën Supreme me 17-06-2010.

<sup>17</sup> Nga 8 lëndë sa janë parashkruar nga neni 339 i KPK-së, shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit, 1 lëndë është nga Prishtina, 1 nga Malisheva, 4 nga Gjakova, dhe 2 janë nga Istogu.

<sup>18</sup> Lënda nga neni 348 i KPK-së, falsifikimi i dokumentit zyrtar është nga Suhareka.

**Tabela 4. Veprat Penale që janë parashkruar më së shumti.**

Kapitujt sipas KPK-së	Neni dhe Vepra Penale	Numri i Lëndëve
<b>Kap 28 i KPK-së</b>	Neni 332- Falsifikimi i Dokumentit	<b>285</b>
<b>Kap 24 i KPK-së</b>	Neni 285- Vjedhja e Pyllit	<b>595</b>
<b>Kap 23 i KPK-së</b>	Neni 261- Mashtrimi	<b>270</b>
<b>Kap 23 i KPK-së</b>	Neni 252- Vjedhja	<b>360</b>
<b>Kap 15 i KPK-së</b>	Neni 153- Lëndim i Lehtë Trupor	<b>232</b>
<b>TOTALI</b>		<b>1742</b>

Po të bazohemi në tabelën e lëndëve të parashkruara të ndara në bazë të kapitujve të KPK-së, del se 4 lëndë që janë parashkruar i përkasin kapitullit 14 Veprat Penale Kundër të Drejtës Ndërkombëtare. Këto lëndë janë: **neni 130** shtyrja për luftë agresive ose konflikt të armatosur<sup>19</sup> 2 lëndë, **neni 132** rrëmbimi i fluturakes<sup>20</sup> 1 lëndë, dhe **neni 134** rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar<sup>21</sup> 1 lëndë. Parashkrimi i këtyre lëndëve nga ana e

<sup>19</sup> **Kodi Penal i Kosovës, Neni 130 SHTYTJA PËR LUFTË AGRESIVE OSE KONFLIKT TË ARMATOSUR**

Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, incizimeve audiovizuale, ose në ndonjë mënyrë tjetër thërret ose nxit për luftë agresive apo konflikt të armatosur, dënohet me burgim prej një deri në tre vjet. Kjo veprë penale është e parashkruar në Gjykatën Komunale të Prishtinës në vitin 2006. Dhe në Gjykatën Komunale të Malishevës në vitin 2005, me numër të lëndës 175/05.

<sup>20</sup> **Kodi Penal i Kosovës, Neni 132 RRËMBIMI I FLUTURAKES**

(1) Kushdo që në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e rrëmbimit të kundërligjshëm të fluturakes të datës 16 dhjetor 1970 në fluturake përvetëson ose kontrollon në mënyrë të paligjshme fluturaken me dhunë ose me kanosje a në ndonjë mënyrë tjetër kërcënuese dënohet me së paku një vit burgim.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni shkakton vdekjen e një apo më shumë personave ose bën shkatërrimin e fluturakes, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(3) Kushdo i cili me dashje privon personin tjetër nga jeta me kryerjen e veprës nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë. Kjo lëndë është parashkruar në Gjykatën Komunale të Malishevës në vitin 2007, me numër të lëndës 42/07.

<sup>21</sup> **Kodi Penal i Kosovës, Neni 134 RREZIKIMI I SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR**

(1) Kushdo i cili në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar të datës 10 mars 1988 kryen një akt të rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar, dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Akt i rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:

- 1) Pushtimi i anijes ose ushtrimi i kontrollit mbi të me dhunë a me kërcënim apo me çfarëdo forme të frikësimit;
- 2) Kryerja e një akti të dhunës kundër një personi drejtues të anijes nëse ai akt ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;
- 3) Shkatërrimi i anijes ose shkaktimi i dëmit anijes ose i ngarkesës që ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;
- 4) Vendosja ose mundësimi i vendosjes në anije të çfarëdo mjeti a substancës që ka gjasë për ta shkatërruar atë anije ose për të shkakuar dëm asaj a ngarkesës së saj që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;

Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe asaj të Malishevës, është në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare. “Nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit mbi ekzekutimin e dënimit për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi”<sup>22</sup>.

### **Kundërthëniet në mes Gjykatës Supreme dhe Gjykatave Komunale**

Numri i lartë i parashkrimit të lëndëve, përgjatë këtyre viteve të marrë në shqyrtim, ka ardhur edhe si rrjedhojë e tendencës për të plotësuar normën e përcaktuar të lëndëve që duhet shqyrtuar dhe mbyllur përgjatë një viti nga një gjyqtarë. Për të plotësuar këtë normë, gjyqtarët kanë neglizhuar afatet ligjore, duke vrapuar përmbushjen e numrave/normave, pa e konsideruar edhe rrezikun e vjetërsimit të lëndës. “Nëse do të kishin qenë më të kujdesshëm, parashkrimi nuk do të kishte ndodhur për fajin e gjyqtarëve, sepse fundi i fundit fajtor për parashkrimin absolut nuk jemi ne”.<sup>23</sup>

Përkundër faktit që 54 % e lëndëve që janë parashkruar i përkasin parashkrimit relativ, pa llogaritur edhe ato të pa kategorizuara, prapë se prapë nuk është ndërmarrë asnjë veprim kundër përgjegjësve të këtyre parashkrimeve.

Nga 4197 lëndë të parashkruar gjithsej nga gjykatat komunale të Kosovës që janë marrë për shqyrtim të kësaj analize, 1639 lëndë i përkasin parashkrimit absolut, që nënkupton se ka kaluar dyfishi i afatit të paraparë me KPK, për parashkrim/vjetërsim. Për këto 1639 lëndë që janë parashkruar në aspektin absolut, nuk ekziston asnjë mundësi që të ndërmerret ndonjë veprim nga gjykatat, për arsye se tek parashkrimi absolut i lëndëve, barra e përgjegjësisë nuk qëndron tek gjykatat, sepse ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë më ligj për ndjekjen penale ose ekzekutimin e dënimeve. Kjo për

5) Shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pajimeve të navigacionit detar apo ndërhyrja e rëndë në operimin e tyre nëse një akt i tillë ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;

6) Komunikimi i informacionit për të cilin kryerësi e di di se është i rrejshëm me çka rrezikon lundrimin e sigurt të anijes.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e anijes, kryerësi dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

(4) Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër duke kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

(5) Kushdo që nga pakujdesia kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim deri në tre vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni ka pasojë vdekjen e një ose më shumë personave ose shkatërrimin e anijes, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet. Kjo lëndë është parashkruar në Gjykatën Komunale të Malishevës në vitin 2005, me numër të lëndës 180/05.

<sup>22</sup> Kodi Penal i Kosovës neni 95.

<sup>23</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

arsye se ose nuk ka qenë e mundur të gjendet pala e dyshuar, ose nuk është arritur të gjendet i dënuari.

Kryetarët e shumicës së gjykatave komunale janë arsyetuar se numri kaq i madh i parashkrimit të lëndëve ka ndodhur për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe stafit administrativ të gjykatave. Kjo sa i përket parashkrimit të ndjekjes penale. Faktori objektiv, mungesa e gjyqtarëve, për një kohë shumë të gjatë ka ndikuar në rritjen e lëndëve, të cilat më pastaj po vijnë deri te vjetërsimi. Zyra e Prokurorit Disiplinor pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka qenë e përqendruar në ato raste manipulative, ku gjyqtari duke neglizhuar funksionin e vetë gjyqësor, ka kontribuar në masë të madhe që të vijë te vjetërsimi i një lëndë. “Dyshimet tona janë që ka pasur raste që qëllimisht të vijë deri te vjetërsimi i lëndëve, por në krejt këtë fatkeqësi ka një fatkeqësi tjetër, të gjithë ata bartës të atyre lëndëve tani nuk janë më në detyrë. Po i hulumtojmë rastet po vijmë deri të një provë që kjo mund të jetë e qëllimshme, por rezultati është zero sepse ne nuk mund të iniciojmë asnjë procedurë ndaj ish-gjyqtarëve”.<sup>24</sup>

Pamundësia për të iniciuar procedurë nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, po u lë hapësirë gjyqtarëve që të lejojnë parashkrimin e lëndëve penale me ose pa dëshirë, te japin dorëheqje nga detyra e gjyqtarit dhe asnjëherë mos të japin llogari për punën ose mos punën e tyre. Lejimi më qëllim i parashkrimit relativ të lëndëve mund të jetë vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe për këtë, gjyqtarët duhet të ndiqen penalisht.

Kryeprokurori i Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë z. A. Lumezi, deklaron se “unë e di që në gjykata ka pasur numër të madh të lëndëve të pakryera dhe për shkak të ngarkesës së madhe ka ardhur deri të parashkrimet. Ne deri me tani nuk kemi informata se është keqpërdorur detyra zyrtare. Po të kishim informata se kjo është bërë me qëllim që lëndët të arrijnë deri të parashkrimi sigurisht që do t’i kishim hetuar ata gjyqtarë”.<sup>25</sup>

Përgjegjësit e parashkrimit të mijëra lëndëve mund të mbesin edhe pa u ndëshkuar për faktin se pjesa më e madhe e gjyqtarëve të cilët kanë kryer veprime të tilla tashmë nuk janë duke punuar si gjyqtarë, përkatësisht ose janë punësuar si avokatë ose janë nuk janë riemëruar në procesin e riemërimit.<sup>26</sup> Për Begollin, fakti se përgjegjësit nuk punojnë më si gjyqtarë, paraqet një problem të madh. Zyra e Prokurorit Disiplinor, nuk ka mandat të shqiptojë sanksione për gjyqtarët të cilët nuk janë duke punuar për momentin në drejtësi, mirëpo sipas Begollit në këto raste mund të ketë punë

<sup>24</sup> Intervistë me Kadri Begollin prokuror në Komisionin Disiplinor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Me 18-01-2012.

<sup>25</sup> Kosova Sot “*Disa gjyqtarë nën Hetim*”, 9-dhjetor 2011, faqe 5.

<sup>26</sup> Kosova Sot, “*Në qershor nisin hetimet për vjetërsimin e lëndëve*”, 13 maj 2011, faqe 9.

Kryeprokurori i Shtetit, i cili mund të kërkojë përgjegjësi penale për shkeljet eventuale. As Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe as Prokuroria e Shtetit, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim deri tash për të hetuar dhe sanksionuar fajtorët e një numri kaq të madh të lëndëve të parashkruar nga aspekti relativ. Edhe pse potencohet fakti se 9 gjyqtarë janë në procedurë hetimi për shkak të parashkrimit të lëndëve, akoma nuk ka asnjë veprim konkret.

Është absurde se si ish gjyqtarët që kanë lejuar parashkrimin e lëndëve penale me vite, tash të kenë të drejtë të ushtrojnë profesionin e avokatit. Ata të cilët kanë amnistuar krimin dhe kriminelët me vite, tani kanë të drejtën e mbrojtjes së qytetarëve!

Ndërsa sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve, gjyqtarët arsyetohen se nuk ka një gatishmëri të Policisë së Kosovës për përgjigje në urdhëresat e gjykatave për arrestimin e të dënuarve. Po ashtu, gjyqtarët arsyetohen se në shumë raste kanë probleme me adresat e të dyshuarve dhe të dënuarve, pasi që nuk arrihet të gjinden në adresat që kanë ata. "Adresat për gjykatat kanë paraqitë problem sepse kjo ka ndikuar te gjykatat për zvarritjen e rasteve, shtyrje të afatit dhe ka krijuar shpenzime të mëdha, sepse është dashur tre-katër herë të kërkohet pala. Kur është në pyetje policia kjo nuk qëndron, sepse ata janë të thirrur të gjejnë edhe adresat, ata e kanë operativen e vetë për t'i gjetur adresat."<sup>27</sup>

Gjithashtu, problem në fillimin e ndjekjes dhe fillimin e ekzekutimit të dënimeve është edhe arratia e të dyshuarve dhe të dënuarve. Një numër i madh i të dyshuarve dhe të dënuarve gjenden në botën e jashtme dhe nuk mund të arrestohen dhe të sillen në gjykim ose në vuajtje të dënimeve të shqiptuara.

Gjykata komunale e Gjakovës dhe ajo e Klinës, kanë së bashku 603 lëndë që iu janë parashkruar dhe nuk i kanë ndarë se sa janë parashkrim absolut dhe sa relativ. Nga këto lëndë, 304 janë nga Gjykata Komunale e Gjakovës, dhe që sipas Rudin Elezit administrator i kësaj gjykate, këto janë lëndë që i përkasin parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve, që d.m.th. gjykata i ka shqyrtuar lëndët, ka shqiptuar dënimet, por nuk është arritur të arrestohen nga Policia e Kosovës për t'u sjellë në institucionet korrektuese për të vuajtur dënimet e shqiptuara. Mos arrestimi i tyre me kohë, ka sjellë edhe parashkrimin e ekzekutimeve të dënimeve. Për këtë, gjykatat fajësojnë policinë, "ndodhë që tri herë të dërgohen urdhëresa tek policia dhe ata nuk përgjigjen në urdhëresa"<sup>28</sup>. Përkundër kësaj, kryetari i Gjykatës Supreme Fejzullah Hasani, thotë se

<sup>27</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

<sup>28</sup> Znj. Safete Tolaj Kryetare e Gjykatës Komunale e Deçanit në intervistën dhënë Organizatës ÇOHU! Thotë se kemi probleme me policinë rreth ekzekutimit të dënimeve nga policia, ata nuk përgjigjen në urdhëresat e gjykatës, kemi derguar deri në tri urdhëresa për të njëjtën qështje edhe nuk kemi marrë përgjigje.

bashkëpunimi me policinë ka qenë korrekt, por mund të themi se ka pasur segmente ku kemi pasur probleme. Ka qenë njësitë që merret me urdhëresat e gjykatave, këtu kemi probleme dhe kjo dëshmohet te parashkrimi absolut, sepse parashkrimi absolut nuk ndodhë për shkak të gjykatave.

Po ashtu, problemi qëndron se policia me rastin e pranimit të kallëzimit penal nuk i merr të gjitha të dhënat e nevojshëm që obligohen me ligj të merren, pastaj lindë problemi i adresave<sup>29</sup> të të dyshuarve.

Marrë në përgjithësi arsyetimet e gjyqtarëve rreth vjetërsimit të lëndëve panele janë:

- **numri i madh i lëndëve,**
- **numri i vogël i gjyqtarëve,**
- **mos gjetja e të pandehurve as nga ana e gjykatës, as nga policia,**
- **adresat e gabuara,**
- **fshehja e të pandehurve për t'iu shmangur përgjegjësisë penale,**
- **moszbatimi i urdhëresave të gjykatave nga policia,**
- **lëndët jo të kompletuara nga prokuroritë,**
- **mungesa e stafit ndihmës gjyqësor,**
- **parashkrimi në procedurën parapenale në polici,<sup>30</sup>**
- **mos zëvendësimi i gjyqtarëve etj.**

Arsyetimet e gjykatave rreth parashkrimit të lëndëve mund të jenë reale sa i përket lëndëve që janë parashkruar nga aspekti absolut, mirëpo nuk janë reale sa iu përket parashkrimeve relative, sepse gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për të ndërprerë afatin e parashkrimit. Kjo nënkupton se gjykatat nuk i kanë marrë fare në shqyrtim gjyqësor lëndët që janë parashkruar në aspektin relativ, dhe kështu kanë lejuar parashkrimin e tyre pa i shqyrtuar fare. “Parashkrimi relativ lë për të dyshuar se mos këtu diçka ka ndodhur, nuk ka sinjale të mira, nëse del se parashkrimi relativ ka ndodhur për shkak të

{Arsyetimet e gjykatave rreth parashkrimit të lëndëve mund të jenë reale sa i përket lëndëve që janë parashkruar nga aspekti absolut, mirëpo nuk janë reale sa iu përket parashkrimeve relative, sepse gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për të ndërprerë afatin e parashkrimit}

<sup>29</sup> Vërtetë është një problem shumë kompleks ky i parashkrimit të lëndëve penale. Gjyqësori po përballet me probleme le të themi më banale, për shembull emërtimin e rrugëve. Kadri Begolli 18-01-2012.

<sup>30</sup> Gjykata Komunale e Pejës arsyetohet se shumica e lëndëve të parashkruara kanë ardhur të parashkruar në procedurën parapenale në polici.

keqpërdorimeve apo abuzimeve atëherë do të ndërmerren masa”<sup>31</sup>. Dhe për këtë duhet të fajësohen gjyqtarët që kanë qenë të ngarkuar me ato lëndë. “Nuk qëndron fakti se gjyqtarët kanë qenë të ngarkuar me lëndë, ngase sa do të jetë i ngarkuar me lëndë gjyqtari, nuk duhet të lejoj që nga mospuna e tij të vjetërsohet lënda. Dhe kjo është lehtë të vërtetohet, që nëse një gjyqtar është marrë vetëm me lëndë që nuk kanë qenë afër vjetërimit, pra është marrë me numra nuk është marrë me lëndë që kanë qenë në rrezik, d.m.th. tregon se ai e ka neglizhuar çështjen.”<sup>32</sup>

## **Përfundimi**

Me mijëra lëndë penale parashkruhen/vjetërsohen në gjykatat e Kosovës me arsyetimin e numrit të madh të lëndëve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve dhe stafit administrativ gjyqësorë. Megjithatë, deri me tani nuk është ndërmarrë asnjë masë nga organet kompetente për shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor që të parandalohet numri kaq i madh i lëndëve të vjetërsuara.

Numri më i madh i lëndëve të parashkruara në gjykatat komunale i përket aspektit relativ të parashkrimit, që nënkupton se ka kaluar afati i paraparë me ligj, për ndërmarrjen e çdo mase penale ndaj të dyshuarve/të dënuarve. Për numrin kaq të madh të lëndëve të parashkruara në aspektin relativ, fajtor kryesor janë gjyqtarët, kjo për arsye të mos ndërmarrjes së veprimeve ligjore të parapara me ligj për ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Edhe pse fajësohen gjyqtarët për parashkrimin relativ të lëndëve, deri me tani nuk është ndërmarrë asnjë masë as disiplinore dhe as penale ndaj gjyqtarëve që kanë qenë të ngarkuar për t’i shqyrtuar lëndët, ndërsa ata përkundër kësaj kanë lejuar vjetërsimin e lëndëve duke i dërguar në parashkrim.

Një pjesë e lëndëve të parashkruara, i përkasin parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve. Kjo nënkupton se gjykatat kanë gjykuar rastet kanë shqiptuar dënimet, mirëpo të dënuarit nuk janë arrestuar për tu dërguar pastaj në institucionet korrektuese për të vuajtur dënimin. Për këtë, duhet fajësuar policia e cila nuk ka mundur të ekzekutoj vendimet e gjykatave për arrestimin e të dënuarve. Kjo flet për një bashkëpunim jo të mirë në mes të Policisë së Kosovës dhe të gjykatave, sidomos në aspektin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Për parandalimin e parashkrimit të numrit kaq të madh të lëndëve penale (në aspektin relativ), në të ardhmen, është e nevojshme rritja e numrit të gjyqtarëve dhe

<sup>31</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

<sup>32</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

---

stafit gjyqësor, rritja e bashkëpunimit në mes të policisë dhe gjykatave, dhe përfundimisht rritja e nivelit të përgjegjësisë tek gjyqtarët. Nëse parashkruhet një lëndë të dihen arsyet e parashkrimit, dhe nëse fajtor është gjyqtari për parashkrim të ndërmerren masat disiplinore dhe penale ndaj tij.